



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 2269 Prot.

Tiranë, më 12.03.2020

U R D H Ë R

Nr. 131, datë 12.03.2020

**“PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NË PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19 PËR TË SËMURËT KRONIKË QË
TRAJTOHEN ME BARNA ME RIMBURSIM”**

Në mbështetje të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkronjës “r”, të pikës 1, të nenit 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 05.03.2014, “Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, të udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit nr. 11, datë 16.07.2019 “Për përshkrimin e recetës elektronike nga mjekët specialistë të spitalit me barnat nga lista e barnave të rimbursuara, që tregtohen nga farmacitë e spitalit dhe procesin e administrimit nga DAPSHET/DRF”, të urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 156, datë 10.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” dhe të Kontratës “Për lëshimin e recetës me rimbursim nga mjeku specialist për barnat që tregtohen në farmacinë e spitalit”, me qëllim shmangien e grumbullimit të pacientëve dhe për shkak të situatës së krijuar;

U R D H Ë R O J:

1. Mjekët specialist të QSUT që kanë kontratë me Fondin për lëshimin e recetës elektronike me rimbursim së bashku me stafet ndihmëse, të njoftojnë të gjithë pacientët kronikë që barnat e rimbursuara do të tërhiqen direkt pranë farmacisë së QSUT. Mjekët specialist të QSUT, të gjenerojnë recetën elektronike në sistemin e-Rx, për të gjithë pacientët kronikë, duke respektuar afatet e recetës elektronike. Kodi i recetës elektronike t’i dërgohet me mesazh pacientit kronik.
2. Mjekët specialist të spitalit rajonal/bashkiak së bashku me stafin ndihmës të kontaktojnë pacientët kronikë për tërheqjen e barnave me rimbursim pranë farmacisë së spitalit. Mjekët specialistë të gjenerojnë recetën elektronike në sistemin e-Rx për të gjithë pacientët kronikë. Kodi i recetës elektronike t’i dërgohet me mesazh pacientit kronik.

3. Mjekët specialist të rajonit, të cilët trajtojnë këta të sëmurë kronikë në zbatim të konsultës së shërbimit të QSUT-së, të vazhdojnë trajtimin e tyre sipas protokolleve të përdorimit të barnave dhe protokolleve klinike të diagnozës. Në rastet kur kërkohet konsultë e domosdoshme me mjekët e shërbimeve mjekësore të QSUT-së, për arsye të gjendjes klinike të pacientit, mjeku specialist i rajonit të konsultojë të sëmurin me mjekun specialist të shërbimit mjekësor universitar, nëpërmjet telemjekësisë, apo çdo komunikimi tjetër zyrtar, që e gjykon të arsyeshme.
4. Sektori përkatës i DAPSHET-it dhe DRF-ve të Fondit të koordinojnë procesin me mjekët specialist për të shmangur rradhët, në zbatim të urdhëzimit të Fondit nr. 11, datë 16.07.2019 “Për përshkrimin e recetës elektronike nga mjekët specialistë të spitalit me barnat nga lista e barnave të rimbursuara, që tregtohen nga farmacitë e spitalit dhe procesin e administrimit nga DAPSHET/DRF”.
5. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet DAPSHET-i dhe Drejtoritë Rajonale të Fondit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë deri në njoftim të dyte të përmirësimit dhe stabilizimit të situatës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rudina Degjoni

